

**FONDI SHQIPTAR I ZHVILLIMIT**  
**FORMULARI I NJOFTIMIT TE FITUESIT**

[ Data : 14.05.2017]

**Për: Operatorin Ekonomik “Fusha” shpk**

Procedura e prokurimit: **“Tender i Hapur”** me objekt : **"Ndertimi Shetitores Mak Albania-Pusi Nr.1 dhe Rehabilitimi i kanalit Kullues KK1, Golem, Kavaje”.**

Përshkrim i shkurtër i kontratës: **"Ndertimi Shetitores Mak Albania-Pusi Nr.1 dhe Rehabilitimi i kanalit Kullues KK1, Golem, Kavaje”.**

Kohëzgjatja: brënda 14 muajsh nga data e fillimit te punimeve.

Fondi limit: 567.154.000 (pesëqind e gjashtëdhjetë e shtatë milion e njëqind e pesëdhjetë e katër mijë) Lekë pa TVSH.

Fondi i akorduar për vitin 2017 është 113.614.127 (njëqind e trembëdhjetë milion e gjashtëqind e katërmëdhjetë mijë e njëqind e njëzet e shtatë) lekë pa tvsh. Pjesa e mbetur është parashikuar për vitin 2018.

Burimi i financimit: Buxheti i Shtetit.

Data e zhvillimit të procedurës së prokurimit: **Datë 04.04.2017.**

Publikime të mëparshme (nëse zbatohet): Nuk ka patur.

Njoftojmë se, kanë qënë pjesëmarrës në procedurë këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara pa tvsh:

| Nr | Shoqëria                               | Oferta lek pa tvsh para kontrollit aritmetik |
|----|----------------------------------------|----------------------------------------------|
| 1  | "Vellezerit Hysa" sh.p.k               | 403,785,410                                  |
| 2  | "Fusha" sh.p.k                         | 419,624,728                                  |
| 3  | "Delta Lavori"                         | 428,398,083                                  |
| 4  | "Pe Vla Ku" sh.p.k                     | 435,257,679                                  |
| 5  | "Lala" sh.p.k                          | 481,140,307                                  |
| 6  | "G.P.G." sh.p.k                        | 497,286,295                                  |
| 7  | "Victoria Invest"International" sh.p.k | 498,568,543                                  |
| 8  | "Gener 2" sh.p.k                       | 509,703,651                                  |
| 9  | "Varaku E" sh.p.k                      | Nuk ka paraqitur oferte                      |

Pas vleresimit te dokumentacionit te paraqitur komisioni me unanimitet vendosi:

1. **Te skualifikoje bashkimin e perkohshem te shoqerive “Delta Lavori” shpk (43.7%), “Company Riviera 2008” shpk (33.5%) “Ndrekaj” shpk (16%) dhe “Kacdedja” shpk (6.8%) per arsye se:**

Sipas marreveshjes se bashkepunimit shoqerise ”Company Riviera 2008” shpk i takon te kryeje nje volum punimesh prej 143.513.357 lekesh pa tvsh, nderkohe qe kjo shoqeri zoteron piken e licenses NP-4C e cila i lejon te kryeje ne te njejten kohe punime me vlere te pergjithshme jo me shume se 100.000.000 leke. Bazuar ne Vendimin e Keshillit te Ministrave nr 42, date 16.01.2008, Kreu III, pika 1, paragrafi IIb kjo shoqeri duhet te skualifikohet.

Duke qene se kjo e mete eshte thelbesore, komisioni vendosi te mos vazhdoje me me shqyrtimin e dokumentacionit te mbetur per kete bashkim shoqerish.

2. **Te skualifikoje bashkimin e perkohshem te shoqerive “Victoria Invest International” shpk (50.98%) dhe “Victoria Invest” (49.02%) per arsye se:**

Shoqeria “Viktoria Invest International” shpk nuk ploteson piken 2.3.1 te Kerkesave te Vecanta per Kualifikim lidhur me punet e ngjashme, pasi per te provuar realizimin e puneve te ngjashme ka paraqitur dokumentacion per realizimin e objekteve:

“Rruga Librazhd Qafe Stude”, realizuar ne vitet 2011 – 2015. Vlora e punimeve pa tvsh te kryera ne 3 vitet e fundit per kete objekt eshte 139.915.746 leke.

“Rruga Grekan Vlashuk”, realizuar ne vitet 2013 – 2014. Vlora e punimeve pa tvsh te kryera ne 3 vitet e fundit per kete objekt eshte 160.818.666 leke.

Bazuar ne perqindjen e puneve qe ka marre persiper (50.98%), kjo shoqeri per te provuar plotesimin e kriterit per kualifikim duhet te kishte paraqitur dokumentacion per realizimin e nje pune te vetme ne tre vitet e fundit me vlere jo me pak se 283.577.000 leke pa tvsh ose te disa puneve te realizuara ne tre vitet e fundit me vlere jo me pak se 578.270.218 leke pa tvsh.

Ky operator ekonomik, me dokumentacionin e paraqitur, nuk ploteson asnjeren prej kushteve.

Shoqeria “Viktoria Invest” shpk nuk ploteson piken 2.2.4 te Kerkesave te Vecanta per Kualifikim lidhur me taksat vendore pasi, referuar puneve ne proces te deklaruar, nga viti 2016 ushtron aktivitet ne Librazhd (ne objektin ”Rikualifikim urban, zona ne hyrjen perendimore te qytetit Librazhd dhe mbrojtje lumore”, me vlere 82.200.510 leke) dhe ne Bilisht (ne objektin “Rikualifikim urban i qendres se qytetit Bilisht, loti i”, me vlere 102.536.108 leke. Per keto dy objekte nuk ka paguar detyrimet vendore dhe nuk i ka regjistruar ne QKB.

Shoqeria “Viktoria Invest International” shpk nuk ploteson piken 2.2.4 te Kerkesave te Vecanta per Kualifikim lidhur me taksat vendore pasi, referuar puneve ne proces te deklaruar, kryen aktivitet ne Tirane nga viti 2015 e ne vazhdim dhe nuk ka paraqitur dokumentacion per shlyerjen e detyrimeve vendore.

3. **Te skualifikoje shoqerine “Varaku E” shpk per arsye se: nuk ka paraqitur oferte.**
4. **Te skualifikoje bashkimin e perkohshem te shoqerive “Vellezerit Hysa” shpk (58% %) dhe “Ergi” (42%) per arsye se:**

Shoqeria “Vellezerit Hysa” shpk nuk ploteson piken 2.3.5 per kualifikim lidhur me punesimin e mjekut te shoqerise, pasi mjeku nuk figuron ne listepagesat e muajve janar dhe shkurt 2016 nderkohe qe eshte kerkuar te kete qene ne stafin e shoqerise nga Janari 2016 e ne vazhdim.

Shoqeria “Ergi” shpk nuk ploteson piken 2.3.3 per kualifikim lidhur me stafin pasi nuk ka paraqitur dokumentacion per punesimin e nje arkitekti, nje inxhinieri ndertimi me profil struktura, nje inxhinieri mekanik, nje agronomi dhe nje inxhinieri elektrik. Duke qene se ne marreveshjen e bashkepunimit nuk jane percaktuar punet konkrete qe do te kryeje secila shoqeri “Ergi” shpk duhet te kishte te punesuar edhe keta inxhinieri.

Shoqeria “Ergi” shpk nuk ploteson piken 2.3.5 per kualifikim lidhur me punesimin e mjekut te shoqerise, pasi nuk ka mjek te punesuar.

Shoqeria “Ergi” shpk nuk ploteson piken 2.3.6 per kualifikim lidhur me pikat e nevojshme te licenses pasi nuk disponon piken e licenses N.S – 10. A - Shtresa dhe mbistruktura speciale. Duke qene se ne marreveshjen e bashkepunimit nuk jane percaktuar punet konkrete qe do te kryeje secila shoqeri “Ergi” shpk duhet te kishte edhe kete pike license.

Shoqeria “Ergi” shpk nuk ploteson piken 2.3.1 per kualifikim lidhur me punet e ngjashme, pasi per te provuar realizimin e puneve te ngjashme ka paraqitur dokumentacion per realizimin e objekteve:

- “Kapanoni i letres Mc Donalds” me vlere te realizuar ne tre vitet e fundit 83.682.026 leke pa tvsh.
- “Shkolla e mesme Katund i Ri” me vlere te realizuar ne tre vitet e fundit 26.249.999 leke pa tvsh.
- “Ndertim linja ujesjellesi” me vlere te realizuar ne tre vitet e fundit 52.813.323 leke pa tvsh.

Vlera e plote (pa tvsh) e punimeve te kryera ne tre vitet e fundit per objektet e mesiperm eshte 162.745.348 leke pa tvsh. Ne kete menyre nuk ploteson kushtin per realizimin e nje pune te vetme me vlere jo me pak se 119.102.340 leke pa tvsh dhe as kushtin per realizimin e disa puneve me vlere jo me pak se 476.409.360 leke pa tvsh.

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë **Operatorin ekonomik “Fusha” shpk** se oferta e paraqitur, me vlerë **419.624.728 (katerqind e nentembdhjete milion e gjashteqind e njezet e kater mije e shtateqind e njezet e tete)** lekë pa TVSH është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë **Autoritetit Kontraktor:**

- **Fondi Shqiptar i Zhvillimit**
- **Rr. “Samë Frashëri”, Nr. 10, Tirana, Albania**
- **Phone: 00355 4 2 235 597/8 (int.151)**
- **Fax: 00355 4 2 234 885**

sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda pese ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të konfiskohet siguri i ofertës suaj (nëse është kërkuar) dhe kontrata do t’i akordohet ofertuesit vijues në klasifikimin përfundimtar, siç parashikohet në nenin 58 të Ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

Njoftimi i Klasifikimit (pas rivleresimit) është bërë në datë **23.04.2017**.

Ne datën 14.04.2017 paraqiti ankese shoqeria “Victoria Invest” shpk. Shoqerise ju kthye pergjigje ne datën 18.04.2017 duke refuzuar ankesen.

Ne datën 14.04.2017 paraqiti ankese shoqeria “Fusha” shpk. Shoqerise ju kthye pergjigje ne datën 21.04.2017 duke pranuar ankesen.

Ne datën 27.04.2017 paraqiti ankese shoqeria “Vellezerit Hysa” shpk. Shoqerise ju kthye pergjigje ne datën 02.05.2017 duke refuzuar ankesen.

Ankesa te tjera nuk jane paraqitur.

